



ODA E MJEKËVE TË KOSOVËS
KOSOVO DOCTORS CHAMBER • LEKARSKA KOMORA KOSOVA

REAGIM PUBLIK

Nuk është hera e parë që profesionistët shëndetësor bëhen objekt i ofendimeve, stigmatizimeve dhe akuzave të pabaza dhe qëllimkëqija. Mirëpo, kur këto sulme verbale vijnë nga bashkëprofesionisti, kjo paraqitet si rrethanë rënduese.

Në kohë kur rreziku objektiv dhe i atëqasshëm është pjesë e eksponimit të përditshëm i mjekëve në ushtrimin e profesionit dhe ofrimin e shërbimeve shëndetësore, në kohën kur pandemia ka vrarë deri më tani 7 (shtatë) mjekë dhe më shumë se 250 mjekë janë të infektuar nga virusi COVID-19, në vllugun e ballafaqimit dhe rrezikimit të jetës në këtë betejë, dr. Ilir Tolaj, në cilësi të mjekut baltosë figurën dhe reputacionin e mjekëve në shoqëri duke i bërë vrastarë në pasojë.

Është më se e lehtë që nga kolltuqet e studiove televizive, pa e kaluar asnjë ditë e orë të vetme për tu ballafaquar me tmerrin e pasojave që po shkakton virusi, të flitet me lehtësi sugjeruese se çfarë duhet bërë. Mirëpo këtu nuk qëndron problemi, sepse krahas sugjerimeve dhe kritikave menaxhuese, kemi të bëjmë me akuza të rënda për veprime johumane që i vihen në barrë mjekëve dhe profesionistëve tjerë shëndetësor.

Po ashtu, si specialist infektolog, do të ishte mirë tu shpjegonte qytetarëve që mjekët si klinikist aktualisht janë duke u marrë me pasojën që po shkaktohet nga virusi. E për deri sa shkakun në nivel global është pazgjidhje, për momentin, i njëjti do të duhej ta proklamonte qetësinë, besimin dhe sigurinë publike se kolegët e Tij janë duke bërë më të mirën e mundshme për momerntin. Ne i bëjmë thirrje organeve kompetente që t'i hetojnë deklaratimet e tilla që hedhin dyshime mbi vdekjen e personave si pasojë e trajtimit të pandërgjegjshëm mjekësor. Mirëpo, gjithashtu i bëjmë thirrje po të njëjtave institucioneve që në rast se këto deklarime nuk vërtetohen, kallxuesi i tyre të merret në përgjegjësi penale për kallëxim publik penal.

Ne jemi koshientë që si organizatë të ushtrime mbikëqyrjen etike dhe profesionale të mjekëve, mirëpo gjithashtu nuk do të rrijmë duarkryq ndaj akuzave të pabaza që u bëhet komunitetit tonë në formë të përgjithësimeve.

Poashtu, bëjmë thirrje organeve punëdhënëse që të verifikojnë ligjshmërinë dhe aspektin etik të të punuarëve të vetë, në këtë rast Fakulteti i Mjeksisë dhe Ministria e Shëndetësisë.

Mjekët dhe profesionistët tjerë shëndetësor do të qëndrojnë bashkë në këtë betejë, pa marrë parasysht pluhurit që është duke u ngritur nga individë të caktuar.